



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 403/ 12 prot.

Datë 18 .03.2025

V E N D I M
Nr. 380/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 305/2025, datë 27.02.2025, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

Ankimues: BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK me Nipte: .L82210031Q , L42202028V.
Adresa:Rr. Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2.
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.),Adresa: Rajoni Nr.1, Rr: “Boris Plumbi”, Nr.20, Korçë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit

të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr.305/2025, datë 27.02.2025, vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Nexia AL Consulting” ShPK dhe “PRIMUS ALBANIA” ShPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.41/27 prot., datë 04.03.2025, protokolluar me tonën nr. 403/8 prot., datë 10.03.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 305/2025 datë 27.02.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.41/27 prot., datë 04.03.2025, protokolluar me tonën nr. 403/8 prot., datë 10.03.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 305/2025 datë 27.02.2025.

Bashkëlidhur shkresës, autoriteti kontraktor ka përcjellë: Vendim nr. 2, datë 04.03.2025 me objekt “Rivlerësim i Ofertave”, Shkresën me objekt: Kërkesë për sqarim mbi vlefshmërinë e Autorizimit datë 19.07.2016, si edhe Printime nga Sistemi.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës më datë 04.03.2025 në përputhje me me konstatimet e Vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin Nr. 305/2025 datë 27.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me REF-35580-01-20-2025 me objekt: “Blerje shërbimi zhvillimi dhe konfigurime për sistemin e fiskalizmit të faturave tatimore elektronike”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 31-01-2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A Korçë (UKRK SH.A.).
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

